




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-3430/14
Nr. i faq. Broj stranica 02	Data Datum 02-10-2014
PRISTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.09.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-2455-14 për z.Elmi Shabani-Këshilltar Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, për shkak se është shmangur dhe parandaluar situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-2455-14, për Zyrtarin e lartë, z.Elmi Shabani - Këshilltar Komunal në Komunën e F.Kosovës dhe njëkohësisht person i autorizuar i biznesit privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Elmi Shabani fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (DPK-01-2646-14), pas të cilës ai është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Shabani është deklaruar do t'i bëjë këto ndryshimet e kërkuara duke inicuar procedurën e shuarjes së biznesit, për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z.Shabani ka kaluar afatatet për të kryer këto veprime të nevojshme, prandaj me datën 29.08.2014 Agjencia kundër Korrupsionit i ka bërë edhe shkresën e dytë, që quhet "Paralajmëruese"(DPK-01-3075-14), me të cilën nga ztr. Shabani është kërkuar që brenda afatit

të caktuar të kryej këto ndryshime në biznes, në të kundërtën Agjencia kundër korrupsionit do të procedoj rastin konform nenit 18 paragrafi 8.

Me datën 25.09.2014, z.Shabani në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), "Informata mbi bizneset", (DPK-03-3365-14), në të cilat shihet se biznesi privat, DPT"Lindi", tanimë, në mënyrë vullnetare është shuar.

Tani, z. Shabani ushtron vetëm funksionin e Këshilltar Komunal në Komunën e Fushë Kosovës.

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

